

**BASHKIA TIRANË**  
**QENDRA KOMUNITARE “TË QËNDROJMË SË BASHKU”**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Tiranë më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Të tjera materjale dhe shërbime speciale (Produkte të shportës)” REF-78367-03-06-2026**

**Loti I-rë:      Objekti: “Blerje produkte ushqimore “ REF-78370-03-06-2026**

**Loti II-të:      Objekti : “Blerje produkte detergjent“ REF-78372-03-06-2026**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- Sheqer te bardhe 15831200-4;
- Oriz 03211300-6;
- Kripe 15872400-5;
- Vaj gatimi 15411200-4;
- Salce domatesh 15331428-3;
- Kafe e pjekur 15861100-2;
- Produkte makaronash 15850000-1;
- Miell I thjeshte 15612130-1;
- Fasule 032212101;
- Detergjent per ene 39831210-1;
- Detergjente 39831200-8;
- Sapun 33711900-6

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Fondi limit:** 2,560,000.00 (dymilion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

**Loti I-rë: “Blerje produkte ushqimore”**

Fondi Limit: 1,559,794.00 (njëmilion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

**Loti II-të: “Blerje produkte detergjent”**

Fondi limit: 1,000,206.00 (njëmilion e dyqind e gjashtë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor, **QENDRA KOMUNITARE TË QËNDROJMË SË BASHKU** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **LOTI I: BLERJE PRODUKTE USHQIMORE**

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të

përfshirë nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

*Argumentimi:* Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1.Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” në përputhje me objektin e prokurimit të lotit 1, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore.

*Argumentimi:* Kërkesa për paraqitjen e licensave të mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 40, pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar; nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat përkatëse lidhur me veprimtarinë për kryerjen e furnizimit të objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomikë duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” të ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore sipas veprimtarisë specifike në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjedisit, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Qënësia e këtyre licensave garanton AK se operatori ekonomik lidhur me stabilimentin që disponon në njërin nga format e sipërcituara ka përmbushur të gjithë parametrat e kërkuar dhe si rrjedhojë është pajisur me këto lloje licencash për kryerjen e veprimtarisë përkatëse duke siguruar në këtë mënyrë AK mbi sigurinë ushqimore.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 1**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/c dhe 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në nenin 42 pika 3 përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit 1**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si mëposhtë:
  - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe\ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55 pika 4 /b dhe nenit 42/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore në vendin/et ku ushtron veprimtarinë.

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të jenë të vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur dhe garantuar sigurinë ushqimore dhe për të mbrojtur konsumatorin e fundit.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikate (të vlefshme), si më poshtë:

Çertifikatën SSH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë SSH EN ISO 22000:2018, është vendosur në bazë të nenit 79 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion çertifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

*-Standarti ISO 22000 specifikon, kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 u drejtohet të gjitha kompanive që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor dhe mund të zbatohet nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga madhësia apo kompleksiteti i tyre.*

*ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:*

- *Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor*
- *Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete)*
- *Menaxhim sistematik*
- *Programet e nevojshme*
- *Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)*

*Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:*

- *Fokus ndaj klientit*
- *Angazhimi i menaxhimit të lartë*
- *Pjesëmarrje aktive e personelit*
- *Qasje ndaj procesit*
- *Përmirësim i vazhdueshëm*
- *Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion*
- *Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara*

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi ne adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore .

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

*kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor sipas nevojave të tyre.*

5. Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin një deklaratë për skadencën e produkteve ushqimore, e cila duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i levrimit të mallit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 2 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Me anë të këtij kriteri të sigurojnë autoritetin kontraktor mbi garancinë e mallit sipas kërkesës së mësipërme.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim:** Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

**Shënim:** Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

## **LOTI 2: BLERJE PRODUKTE DETERGJENT**

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

*Argumentimi:* Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 76 dhe Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar si dhe Neni 25, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 2**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/c dhe 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në nenin 42 pika 3 përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit 2**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si mëposhtë:
  - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
  - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55 pika 4 /b dhe nenit 42/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikate (të vlefshme), si më poshtë:
  - a. Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 për “Menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme në përputhje me objektin e prokurimit të lotit 2, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në

mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi ne adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore .

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor sipas nevojave të tyre.

3. Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin një deklaratë për skadencën e detergjenteve, e cila duhet të jete jo me pak se 1 (nje) vit nga momenti i levrimit të mallit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 2 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Me anë të këtij kriteri të sigurojnë autoritetin kontraktor mbi garancinë e mallit sipas kërkesës së mësipërme.

**Produktet e lotit 1 “Blerje produkte ushqimore” dhe lotit 2 “Blerje produkte detergjent” duhet të jenë me garanci 12 muaj nga momenti i lëvrimit të mallit.**

- Përcaktimi i një periudhe garancie prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga momenti i lëvrimit të mallit për produktet e përfshira në Lotin 1 “Blerje produkte ushqimore” dhe Lotin 2 “Blerje produkte detergjent” është i nevojshëm për të garantuar cilësinë, sigurinë dhe përdorshmërinë e produkteve gjatë gjithë periudhës së përdorimit nga autoriteti kontraktor.
- Së pari, për produktet ushqimore, periudha e garancisë siguron që produktet të jenë në përputhje me standardet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Duke qenë se këto produkte kanë një afat të caktuar skadence, vendosja e një garancie 12 mujore nga momenti i dorëzimit garanton që furnizuesi të marrë përgjegjësi për cilësinë dhe integritetin e produkteve të furnizuara, si dhe të sigurojë që produktet të jenë të përshtatshme për konsum dhe të ruajnë karakteristikat e tyre organoleptike dhe ushqyese gjatë periudhës së përdorimit.
- Së dyti, për produktet detergjente, një periudhë garancie 12 mujore është e arsyeshme pasi këto produkte duhet të ruajnë vetitë e tyre kimike dhe funksionale gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Garancia siguron që produktet të jenë efektive në përdorim dhe të mos pësojnë degradim të cilësisë gjatë magazinimit apo përdorimit normal nga institucioni.
- Në përfundim, përcaktimi i një garancie 12 mujore nga momenti i lëvrimit të mallit për Lotin 1 dhe Lotin 2 konsiderohet një praktikë e arsyeshme dhe proporcionale, e cila garanton cilësinë e produkteve, mbrojtjen e interesave të autoritetit kontraktor dhe përdorimin e sigurt dhe efikas të produkteve gjatë gjithë periudhës së furnizimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim:** Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

**Shënim:** Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentim:** Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të

datës 19.11.2018.. Kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Në zbatim të nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur permendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE PER PRODUKTET USHQIMORE**

### **1. MIELL GRURI**

Bazuar në udhëzimin nr. 207, datë 31.03.2015 i Ministrit të Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave “Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të para paketuar, për t’u shitur te konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”.

#### **Klasifikimi**

Lloji: Miell gruri me rreze 80%

Treguesit shqisor: - - -

Mielli dhe çdo përbërës që shtohet duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për konsum njerëzor;

Mielli duhet të jetë pa erë dhe shije jonormale dhe pa insekte të gjalla;

Mielli duhet të jetë pa papastërti me origjinë shtazore (duke përfshirë dhe insektet e ngordhura) në sasi të dëmshme për shëndetin e njeriut.

#### **Treguesit fiziko-kimikë**

Niveli maksimal i përmbajtjes së lagështisë për miellin, pavarësisht species së grurit nga i cili është përgatitur, është 15% masë/masë;

Aciditeti i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata, % jo më shumë se 0.115.

Hiri i tretshëm, në lëndën absolutisht të thatë, %, jo më shumë se 0.9.

Hiri i patretshëm në acid klorhidrik 10%; në lëndën absolutisht të thatë, %, jo më shumë se 0.1.

Gluteni i njomë, jo më pak se 25%.

Lëndë minerale: Nuk lejohen .

Përzjerje metalike: Plumbi, zinku e bakri nuk lejohen. Lejohet përmbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, jo më shumë se 3mg/g.

Mikroorganizma patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë, nuk lejohen.

Aciditeti i yndyrës: maksimumi 70 mg/100 g miell mbi bazën e lëndës së thatë, e shprehur si acid sulfurik.

Proteina (Nx5,7): mbi 12.5 % mbi bazën e lëndës së thatë.

#### **Mielli duhet të plotësojë kushtet higjienike të vendosura si më poshtë:**

Të jetë pa lëndë të huaja në shkallën që zbatohet procesi optimal teknologjik; -

Sipas metodave të caktuara të marrjes së mostrës dhe analizimit:

i) Duhet të jetë pa mikroorganizma në sasi, të cilat janë të dëmshme për shëndetin e njeriut;

ii) Duhet të jetë pa parazitë, të cilët janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut;

iii) Nuk duhet të përmbajë asnjë substancë me origjinë nga mikroorganizma në sasi të dëmshme

për shëndetin e njeriut.

### **Ambalazhimi, ruajtja dhe transportimi**

Mielli pakëtohet në ambalazhe, të cilat sigurojnë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit.

Ambalazhet duhet të jenë të sigurt dhe të përshtatshme për qëllimin e përdorimit. Ato nuk duhet të mbartin asnjë substancë toksike dhe nuk duhet të kenë shije dhe erë të padëshirueshme për produktin. Kur produkti është pakëtuar në thasë, ato duhet të jenë të pastër, të fortë, të qepur shumë mirë ose të ngjitur mirë.

Mielli etiketohet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 11.07.2018, “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”. Gjithashtu, për etiketimin e tij zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:

- a) Emri i produktit në etiketë duhet të jetë “miell gruri”.
- b) Informacioni për miellin që shitet me shumicë do të jepet ose në ambalazh ose në dokumentet shoqëruese.

Ambalazhimi në pako letre me masë sipas kërkesave të AK-së.

### **Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhënat e mëposhtme:**

- Origjina e produktit - Emri i prodhuesit - Emërtimi i produktit - Pesha neto - Lloji - Data e prodhimit - Data e skadimit - Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve.

### **Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:**

Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti malli. Parti është sasia e miellit e të njëjtës rreze dhe që dorëzohet njëherësh.

Të paraqitet raport-analizë fiziko-kimike pranë AK-së çdo muaj gjatë lëvrimit. Raport-analiza e paraqitur duhet të kryhet në një laborator zyrtar të referencës ose të akredituar (vendas ose i huaj) sipas legjislacionit në fuqi.

### **Ambalazhim 1kg**

## **2.MAKARONA**

Bazuar në SSH 1170:1987 ose ekuivalentin e tij.

### **Klasifikimi:**

Sipas përbërjes: Të thjeshta, të prodhuara nga brumi i përgatitur vetëm me miell gruri.

### **Sipas formës:**

o Fidhe e spageti, me ose pa vrima në mes, me gjatësi 30 deri 60 cm dhe trashësi deri 2,4 mm, në varësi të llojit të makaronave.

o Spirale (Fusili)

o Në formë figurash, etj, me trashësi deri 3 mm, gjatësi jo më shumë 6 mm.

o Peta, sharrë.

### **Kërkesat cilësore:**

Treguesit Shqisorë: -

Pamja: Të jenë me formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht

të ashpra, lejohen përkuljet, shtrembërim e plasaritje të vogla. Mbas zierjes të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen e të mos krijojnë shkume. - -

Ngjyra: E bardhë me nuancë të verdhë. Në thyerje paraqiten gëlqerore në jo më shumë se gjysmën e sipërfaqes së seksionit.

Era dhe shija: E mirë, karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

#### **Treguesit Fiziko–Kimik:**

Lagështia jo më shumë se 13%. -

Aciditeti si acid sulfurik, në %, jo më shumë se 0.16%.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Në çdo ambalazh vendoset një etiketë, ku shënohen:

- Origjina e produktit - Emri i prodhuesit - Emërtimi i produktit - Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit - Data e skadimit - Temperatura e ruajtjes së produktit. - Udhëzimet e përdorimit - Kushtet e ruajtjes

#### **Ruajtja dhe transportimi**

Makaronat ruhen në ambiente të pastra, të thata, të ajrosura dhe të painfektuar, në temperaturë 20°C, me lagështi relative të ajrit deri në 70%. Jetëgjatësia e produktit sipas datës së skadencës në etiketë.

Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve.

#### **Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:**

Marrja në dorëzim bëhet me parti malli. Parti konsiderohet sasia e makaronave të një lloji, me karakteristika të njëjta të prodhuara nga i njëjti prodhues dhe që dorëzohen njëherësh me datë prodhimi dhe datë skadence të përcaktuar.

Karakteristikat fiziko-kimike të mësipërme të jenë të pasqyruara në etiketë.

#### **Ambalazhim 0.5kg**

### **3.ORIZ**

Bazuar në SSH EN ISO 7301:2022 ose ekuivalentin e tij.

#### **Treguesit shqisorë**

Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastra, dhe pa aromë ose erë të huaj që tregojnë përkeqësim. Gjithashtu duhet të jenë pa lëndë toksike ose të dëmshme. Insektet e gjalla të cilat janë të dukshme me sy të lirë nuk duhet të jenë të pranishëm.

Ngjyra: E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

Era dhe shija: Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë të mykur dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit shqisorë sipas SSH EN ISO 7301:2022 ose ekuivalentit të tij.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Në çdo ambalazh vendoset një etiketë, ku shënohen:

- Origjina e produktit - Emërtimi i prodhuesit - Emri i produktit - Peshë neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit - Data e skadimit - Temperatura e ruajtjes së produktit - Udhëzimet e përdorimit
- Kushtet e ruajtjes

### **Ruajtja dhe transportimi**

Orizi ruhet në ambiente të pastra, të thata, të ajrosura dhe të painfektuar, në temperaturë 20°C, me lagështi relative të ajrit deri në 70%. Jetëgjatësia e produktit sipas datës së skadencës në etiketë.

Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve.

### **Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:**

Marrja në dorëzim bëhet me parti malli. Parti konsiderohet sasia e orizit të një lloji, me karakteristika të njëjta të prodhuara nga i njëjti prodhues dhe që dorëzohen njëherësh me datë prodhimi dhe datë skadence të përcaktuara.

Karakteristikat fiziko-kimike të mësipërme të jenë të pasqyruara në etiketë.

### **Ambalazhim 1 kg**

## **4.VAJ LULEDIELLI (USHQIMOR)**

Bazuar në SSH 203:2003 ose ekuivalentin e tij.

### **Kërkesat cilësore:**

Treguesit Shqisorë:

Pamja: Lëng vajor i qartë, pa depozitime.

Ngjyra: E verdhë e lehtë.

Era dhe shija: Karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.

Numri i peroksive: jo më shumë se 10 mek O<sub>2</sub> aktiv / kg Vaj.

Numri i aciditetit: jo më shumë se 0.4 mg KOH/g vaj.

### **Treguesit Fiziko - Kimik:**

Aciditeti si acid oleik: 0.2 gr ne 100 gr/ Vaj.

Dendësia relative (20°C/ ujë në 20°C): 0.918 - 0.923.

Numri sapunifikimit (mg KOH/g vaj): 188 - 194.

Treguesi i jodit(Ēijs): 118 - 141.

Lëndë të pasapunifikueshme: ≤ 15 g/ kg.

Treguesi i refraksionit ( n<sub>D40</sub>) : 1.461-1.468.

### **Ambalazhimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë, ku shënohen:

- Origjina e produktit - Emri i prodhuesit - Emërtimi i produktit - Pesha neto - Lloji - Data e prodhimit - Data e skadimit - Kushtet e veçanta të ruajtjes

**Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:**

Kur konsiderohet e arsyeshme nga AK, të paraqitet raport-analizë fiziko-kimike e cila duhet të kryhet në një laborator zyrtar të referencës ose të akredituar (vendas ose i huaj) sipas legjislacionit në fuqi.

Ruajtja dhe transportimi

Vaji i lulediellit ruhet në mjedise të pastra, pa lagështirë dhe të ajrosura.

Transportimi i vajit bëhet me mjete transporti të caktuara për produktet ushqimore.

Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve.

**Ambalazhim 1 lit**

**5.SHEQER**

Bazuar në SSH 1413:1987 ose ekuivalentin e tij.

**Kërkesat cilësore:**

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja dhe copa sheqeri të ngjeshura, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.

Ngjyra: e bardhë dhe me shkëlqim.

Shija dhe era: Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.

Tretshmëria: Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

**Treguesit fiziko – kimikë:**

Sheqer i pastër i llogaritur me lëndë absolutisht të thatë jo më pak se 99,6%.

Lëndë reduktuese (sheqer invert) %, jo më shumë se 0,1.

Lagështia %, jo më shumë se 0,16.

Hiri %, jo më shumë se 0,07.

**Ambalazhimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Në çdo ambalazh vendoset një etiketë, ku shënohen:

Origjina e produktit

Emri i ndërmarrjes tregtare/prodhuesit

Emërtimi i produktit

Data e prodhimit

Masa neto

Data skadimit

**Kushtet e veçanta të ruajtjes.**

Ruajtja dhe transportimi

Sheqeri ruhet në depo të pastra dhe pa lagështirë. Në depo, reshti i parë i sheqerit të ambalazhuar të vendoset detyrimisht mbi dërrasa, në lartësi 10 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë. Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve. Mjetet duhet të jenë të pastra dhe pa erë të huaj që mund të merret lehtë nga sheqeri. Nuk lejohet që në të njëjtin automjet të transportohen edhe artikuj të tjerë që mund të dëmtojnë sheqerin.

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:

Karakteristikat fiziko-kimike të mësipërme të jenë të pasqyruara në etiketë.

**Ambalazhim 1 kg**

## **6.FASULE TË THATA**

Bazuar në SSH 1723:1987 ose ekuivalentin e tij.

### **Klasifikimi:**

E bardhë

### **Kërkesat cilësore**

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: Kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale , e rumbullakët, e gjatë etj).

Ngjyra: e bardhë.

Era dhe shija: Pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

### **Treguesit fiziko – kimikë:**

Lagështia, %, 15. -

Lëndë të huaja, %, jo më shumë se 0.8.

Në fasulet e bardha të thata lejohen deri në 2% fasule të thata larushe.

### **Ambalazhimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Në çdo ambalazh vendoset një etiketë, ku shënohen:

Origjina e produktit

Emri i ndërmarrjes tregtare/prodhuesit

Emërtimi i produktit

Data e prodhimit

Masa neto

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes.

### **Ruajtja dhe transportimi**

Fasulet e thata ruhen në depo pa lagështirë, të dezinfektuara dhe jo me produktet që kanë erë të huaj. Në depot fasulet e ambalazuara të vendosen stivë njëra mbi tjetrin mbi zgara druri të

ngritura nga sipërfaqja e tokës 10-15 cm. Stivat ndahen nga njëra-tjetra me largësi 50-60 cm dhe larg mureve 50-60 cm.

Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve.

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:

Karakteristikat fiziko-kimike të mësipërm të jenë të pasqyruara në etiketë.

### **Ambalazhim 1 kg**

## **7.SALCË DOMATESH**

Bazuar në SSH 1429-1987 ose ekuivalentin e tij.

### **Kërkesat cilësore**

Treguesit cilësorë:

Pamja e jashtme: Të jetë masë e njëllotë me konsistencë paste, pa fara, pa copa lëkure, të prishura ose të fermentuara.

Ngjyra: E kuqe intensive, karakteristikë e salcës së domates, e njëllotë në të gjithë masën.

Shija dhe era: Karakteristikë e domates pa shije dhe erë të huaj, pa shenja karamelizimi, prishje ose fermentimi.

### **Treguesit Fizikop-Kimik:**

Përmbajtja e ekstraktit të dobishëm, sipas refraktometrit në % të jetë 28-30 % .

Aciditeti i përgjithshëm në raport me ekstraktin i shprehur në acid citrik në %: jo më shumë se 8 %.

Përmbajtja sheqerit të përgjithshëm në % jo më shumë se 20%.

Kripëra të klorur natriumit, të vetë lëndës së parë, %, jo më shumë se: 1.3 %.

Ngarkesa mikrobike: Brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

### **Ambalazhimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Mbi çdo ambalazh vendoset një etiketë ku shënohen: - Origjina e produktit - Emri i prodhuesit - Emërtimi i produktit - Pesha neto - Lloji - Data e prodhimit - Data e skadimit - Kushtet e veçanta të ruajtjes

### **Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:**

Kur konsiderohet e arsyeshme nga AK, të paraqitet raport-analizë fiziko-kimike dhe/ose mikrobiologjike e cila duhet të kryhet në një laborator zyrtar të referencës ose të akredituar (vendas ose i huaj) sipas legjislacionit në fuqi.

Ruajtja dhe transportimi

Salca depozitohet në depo të thata, të freskëta, të pastra dhe të ajrosura mirë, me temperaturë jo më të lartë se 28°C.

Transporti të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore që nuk ndikojnë në

karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike. Jetëgjatësia e produktit sipas datës shënuar në etiketë.

#### ***Ambalazhim 400 Gr***

### **8.KRIPE E JODIZUAR**

Bazuar në SSH 1437: 2005 ose ekuivalentin e tij.

Kërkesat cilësore

Treguesit cilësorë: - - -

Ngjyra: E bardhë.

Era dhe shija: E kripur pa shije dhe erë të huaj.

Pamja e jashtme: Masë kokrrizore.

Treguesit fiziko kimik: - - - - -

Imtësia në mm, në kufijtë: 0.2 – 2.

Klorur Na në lëndën e thatë në %, në kufijtë:  $99 \pm 0.02$ .

Klorur Mg në lëndën e thatë në %, max: 0.23.

Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, në kufijtë  $0.17 \pm 0.02$ .

Lagështirë në %, max: 1.

Jodi në mg/kg kripë:  $40 \pm 0.3$ .

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno-shëndetësore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhënat e mëposhtme. - Origjina e produktit - Emërtimi i prodhuesit - Emri i produktit - Pesha neto - Lloji - Data e prodhimit - Data e skadimit - Kushtet e veçanta të ruajtjes.

Ruajtja dhe transportimi

Kripa e jodizuar ruhet në depo të pastra, të ajrosura mirë dhe të errëta, në kushte normale temperaturë dhe lagështie.

Transporti të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike. Nuk lejohet transporti i kripës ushqimore me mjete që kanë sado pak mbetje të lëndëve kimike, papastërti dhe çdo mbetje tjetër të dëmshme për organizmin e njeriut dhe që i japin kripës aromë, shije e erë të huaj.

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:

Treguesit e mësipërm fiziko-kimikë të jenë të pasqyruar në etiketë.

#### ***Ambalazhim 500 gr***

### **9.KAFE TURKE**

#### **Klasifikimi**

Lloji: cilësi e parë.

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: masë homogjene në formë mielli.

Ngjyra: kafe më të celur.

Era dhe shija: Karakteristike e kafes pa shije dhe erë të huaj.

Lëndë të huaja nuk lejohen.

### **Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit, sipas vendimit Nr.434 datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

Origjina e produktit - - - -

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto

Data e skadimit

### **Kushtet e veçanta të ruajtjes.**

Transporti të kryhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit, si dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

### **Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë**

Verifikim i treguesve në etiketë. Jetëgjatësia e produktit sipas datës së skadencës në etiketë.

***Ambalazhim 100 gr***

## **10. KONSERVA MISHI**

Bazuar në SSH 1544-87

Kërkesat cilësore:

Treguesit Shqisorë:

- Lloji: Të jenë me mish viçi.
- Shija dhe era: E këndshme, karakteristike e mishit të zier sipas lëndës së parë të prodhuar me shijen e piperit të zi dhe të dafinës, pa shije dhe erë të huaj.
- Konsistenca e mishit: Të zierë normalisht të jetë elastike dhe të ruajë strukturën morfologjike të indit.
- Pamja e jashtme e kutisë: E mbyllur hermetikisht pa fryrje, pa deformime mekanike, pa njolla oksidimi, pa dëmtime të shtresës së llakut.

Treguesit fiziko-kimik:

- Sasia e mishit ndaj masës së konservës në përqindje jo më pak se 72%.
- Yndyra jo më shumë se 13%
- Kripa 1-2%

Treguesit mikrobiologjikë:

Ngarkesa mikrobike, brenda normave të sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr 15 dt.09.09.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Konservat e mishit të jenë të ambalazuara në kuti teneqeje, të pastra, të kallajisura ose të llakuara, në masë 0.2-1.0 kg dhe të paketuara në arka druri ose kartoni 5-20 kg.

Etiketimi i produktit mbi çdo kuti konserve të vendoset ose stampohet etiketa të ketë të shënuara:

- Emri apo emërtimi i prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
- Lloji i konservës;
- Lista e përbërësve;
- Sasia neto dhe/ose sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve
- Çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit;
- Vendi i origjinës;
- Data e prodhimit të produktit, afati i skadencës.

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:

Treguesit e mësipërm fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë të jenë të pasqyruar në etiketë.

Ruajtja dhe transportimi

Të ruhet në mjedise të pastra, pa lagështirë. Transportimi i konservës së mishit bëhet me mjete transporti të caktuara për produktet ushqimore. Transportimi të kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportimin e artikujve ushqimorë të përcaktuara në ligjin e ushqimeve. Jetëgjatësia e produktit sipas datës së skadencës pasqyruar në etiketë.

**Ambalazhim 300 gr**

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE PER PRODUKTET DETERGJENT**

### **PRODUKTE DETERGJENT**

**1.Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë:** të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Pluhur me enzima dhe përbërje të avancuar. Përmban sapun, kripra fosfori dhe elementë zbardhës me bazë oksigjeni që japin efekt dhe në ujë të ftohtë dhe temperatura të ulëta. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm<sup>3</sup> deri në 1.1 gr/cm<sup>3</sup>. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95%. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e vogël se 5 cm. **Ambalazhimi në qese plastike me peshë të paktën 4 kg.** Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

### **2.Detergjent për Larjen e Enëve (i lëngshëm)**

Solucion larës enësh lëng: me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të

fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm<sup>3</sup> deri në 1.2 gr/cm<sup>3</sup>. Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%. **Amballazhim 1 lit.**

### **3.Sapun tualeti duarsh:**

Sapun tualeti duarsh: Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm<sup>3</sup>. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm. **Amballazhim 100-125 gr.**

**Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, në përbërje të tij të miratuar me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, ka shqyrtuar dhe hartuar specifikimet teknike për produktet objekt i kësaj procedure prokurimi, duke u bazuar në:**

- Kërkesat konkrete të institucionit dhe funksionin që do të përmbushin produktet e prokuruar
- Katalogut “ Blerje Artikujsh Ushqimorë” 2025 zhornuar të OBP (Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara).
- Katalogut “ Blerje Materialeve Të Ndryshme Për Pastrim” 2025 e perditesuar të OBP (Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara
- Rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.

**Produktet e lotit 1 “Blerje produkte ushqimore” dhe lotit 2 “Blerje produkte detergjent” duhet të jenë me garanci 12 muaj nga momenti i lëvrimit të mallit.**

- Përcaktimi i një periudhe garancie prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga momenti i lëvrimit të mallit për produktet e përfshira në Lotin 1 “Blerje produkte ushqimore” dhe Lotin 2 “Blerje produkte detergjent” është i nevojshëm për të garantuar cilësinë, sigurinë dhe përdorshmërinë e produkteve gjatë gjithë periudhës së përdorimit nga autoriteti kontraktor.
- Së pari, për produktet ushqimore, periudha e garancisë siguron që produktet të jenë në përputhje me standardet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Duke qenë se këto produkte kanë një afat të caktuar skadence, vendosja e një garancie 12 mujore nga momenti i dorëzimit garanton që furnizuesi të marrë përgjegjësi për cilësinë dhe integritetin e produkteve të furnizuara, si dhe të sigurojë që produktet të jenë të përshtatshme

për konsum dhe të ruajnë karakteristikat e tyre organoleptike dhe ushqyese gjatë periudhës së përdorimit.

- Së dyti, për produktet detergjente, një periudhë garancie 12 mujore është e arsyeshme pasi këto produkte duhet të ruajnë vetitë e tyre kimike dhe funksionale gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Garancia siguron që produktet të jenë efektive në përdorim dhe të mos pësojnë degradim të cilësisë gjatë magazinimit apo përdorimit normal nga institucioni.
- Në përfundim, përcaktimi i një garancie 12 mujore nga momenti i lëvrimit të mallit për Lotin 1 dhe Lotin 2 konsiderohet një praktikë e arsyeshme dhe proporcionale, e cila garanton cilësinë e produkteve, mbrojtjen e interesave të autoritetit kontraktor dhe përdorimin e sigurt dhe efikas të produkteve gjatë gjithë periudhës së furnizimit.

**Specifikimet teknike janë formuluar në mënyrë të qartë, të plotë dhe të paanshme, duke garantuar:**

-Pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë në përputhje me parimin e konkurrencës së ndershme

-Barazi trajtimi dhe mosdiskriminim

## **NJESIA E PROKURIMIT**

- **Xhulja Subashi** - Kryetar (Jurist)
- **Mirela Ramazani** - Anëtar (Terapiste)
- **Matilda Shehu** - Anëtar (Psikologe)